REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr.41, Date 22/04/2026

"PER MIRATIMIN E BASHKËORTAKËRISË NËPËRMJET DHURIMIT TË NJË PJESE TË KUOTËS NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ALBEDO SOLAR SHPK "

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417,datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 113 pika 1 shkronja b), Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 68,70,71,-104 të Ligjit Nr. 901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"i ndryshuar, nenit 8,9,54 pika 1 germa d) të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e bashkëortakërisë për zotërimin e kuotës në vlerën 26 % të kapitalit themeltar nëpërmjet dhurimit nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ALBEDO SOLAR SHPK me Nipt M52027505T me objekt "Hartimi, zbatimi dhe administrimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike fotovoltaike dhe gjithe llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne gjithe territorin e Republikes te Shqiperise. Import i makinerive, pajisjeve dhe materialeve te para te nevojshme per prodhimin e energjise te gjitha llojeve dhe venia ne perdorim e tyre, etj."
2. Bashkia Devoll pas pranimit të kuotës do të bëhet zotëruese e 26% të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ligji dhe statuti i shoqërisë.
3. Kjo Shoqëeri do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 901/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
4. Çdo pasuri e luajtshme dhe/ose e paluajthsme në pronësi apo administrim të Bashkisë Devoll që do i vihet Shoqërisë ALBEDO SOLAR SHPK në të cilën Bashkia Devoll do të jetë bashkëpronare, për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim, në të gjitha rastet do të miratohet paraprakisht nga Këshilli i Bashkisë Devoll.
5. Asetet që do ti jepen për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim shoqërisë nuk mund të transferohen, nuk mund të tjetërsohen, por mund të përdoren vetëm në interes të projektit duke marrë në çdo rast miratimin e Këshillit Bashkiak

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

6. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë ose personin e autorizuar prej tij që të nënshkruajë aktet e nevojshme për kuotën dhe ndjekjen e cdo procedure të nevojshme për përfundimin e bashkëortakërisë .
7. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë ose të personit/ave të autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë në Asamblenë e Përgjithshme.
8. Fitimi vjetor i shoqërisë, pasi të jenë shlyer në kohë të gjitha detyrimet tatimore, financiare dhe kontraktuale, përfshirë detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, palëve të treta etj, i transferohet Bashkisë Devoll në masën dhe mënyrën që përcaktohet në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
9. Shoqëria harton cdo vit planin vjetor të veprimtarisë dhe pasqyrat financiare, të cilat miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe i paraqiten Këshillit të Bashkisë Devoll për informim dhe transparencë cdo 6 (gjashtë) muaj.
10. Për zbatimin e tij ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi dhe konfirmoi bazen ligjore:
Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com